



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-24285/2026

Datë: 05.08/2026

Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenet 153 dhe 154, si dhe në nenin 40, paragrafi 2, shkronjat a) dhe l), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 40, paragrafi 2, pika 1, të Statutit të Komunës së Klinës, duke u bazuar në petitionin e parashtruar me nr. 06-351-19272/26, si dhe me propozimin e Ekzekutivit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës, në mbledhjen e VII-të të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më 31.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për shfuqizimin e Vendimit nr. 01Nr.06-19035/2026, për ndryshimin e etazhitetit të lejuar në parcelën kadastrale nr. 495-3, Zona Kadastrale Klinë, nga B+P+2K në B+P+4K, me qëllim të krijimit të kushteve për realizimin e projektit të banimit kolektiv të përballueshëm (social).
2. Shfuqizimi i vendimit bëhet me kërkesë të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, duke u bazuar edhe në petitionin e paraqitur nga banorët e lagjes Dukagjini në Klinë.
3. Vendimi nr. 01Nr.06-19035/2026, i miratuar më 26.06.2026, nuk mund të prodhojë efekt juridik pas shfuqizimit të tij nga Kuvendi i Komunës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës, në pajtim me Ligjin Nr.08/L-284.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Banorët e Lagjes Dukagjini;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

